



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.293/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesues, Skender Çoçaj, dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, paraqitur kundër subjektit politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak– Nenad Rashiqit, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.02.2025, merr këtë :

V E N D I M

I. Pranohet si e bazuar ankesa e Subjekti Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, me shenjën Anr.293/2025 e datës 01.02.2025,

II. Za Slobodu Pravdu i Opstanak– Nenad Rashiqit, me seli në Mitrovicën e Veriut, i shqiptohet dënimi më gjobë në shumë prej 3,500.00 (tremijë e pesëqind) euro, për shkak të të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

III. Subjektit politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak – Nenad Rashiqit, me seli në Mitrovicën e Veriut, detyrohet ta paguaj gjobën në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 01.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë A.nr.293/2025, nga subjekti politik Lista Serbe, paraqitur kundër subjektit politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak– Nenad Rashiqit, në të cilën pretendon se rinia e subjektit politik Lista Serbe me 1 shkurt 2025, në orën 10:00, gjatë monitorimit të aktiviteteve të subjekteve të tjera politike, kanë vërejtur se subjekti politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak— Nenad Rashiq, ka vendosur një billboard në rrugën kryesore të Leposaviqit, përkatësisht në objekt i cili është caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si Qendër për numërimin e votave. Më tutje theksojnë se çfarë bëri që ta merr statusin e objektit publik, duke qenë se në atë objekt do të bëhet numërimi i votave për të

gjitha subjektet politike, në qendrën e numërimit të votave i caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Në vazhdim thuhet se me këtë veprim subjekti politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak–Nenad Rashiq, kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, LZP.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë, fotografimin e posterit të subjektit politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak - Nenad Rashiq, që dëshmon vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me LZP.

Kërkojnë nga paneli që ankesën ta aprovoj si të bazuar, ndërsa subjektit politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak–Nenad Rashiq ti shqiptohet masa e sanksionit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përgjigje në ankesë të Subjektit Politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak - Nenad Rashiq, pretendojnë se fillimisht zyra iu është dhënë nga Komuna e Leposaviqit dhe iu kanë dhënë çelësat për shfrytëzimin e hapësirave gjatë zgjedhjeve për kandidatë për deputetë në Kuvendin e Kosovës për vitin 2025, dhe nuk janë njoftuar se ishte një qendër votimi për numërim, edhe nëse hapësira që në përdorim është një vend për rinumërimin e votave, mendojnë se nuk mund të ndikojë në procesin e votimit kur kjo hapësirë dhe vetë procesi fillojnë vetëm pasi të ketë mbaruar votimi.

Po ashtu në përgjigje në ankesë theksojnë se nëse KQZ-ja, vendos do të hjekin billboardin, sepse e dinë dhe janë të vetëdijshëm që ndalohet promovimi i çdo lloj materiali politik promovues në qendrat e numërimit dhe vendet e votimit. Andaj, kanë bashkangjitur dokumentin në të cilin KQZ-ja, ka bërë vlerësimin e qendrës së numërimit, si dhe emalin e dërguar nga komuna e Leposaviqit (4.9.2024) që i ofron lokalet KQZ-së, për numërim, i cili është në një vend tjetër dhe jo vendi ku ata përdorin ambientet për partinë e tyre.

Më tutje në përgjigje në ankesë theksoj se objekti iu është dhënë në shfrytëzim nga komuna e Leposaviqit dhe nuk kanë njohuri se aty ka një qendër numërimi, siç e kanë shpjeguar në emailin e mëparshëm.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se kandidati Nenad Rashiq, nga subjekti politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak ka bërë shkelje ligjore duke vendosur billboard/poster në ndërtesën publike i cili nga Komisioni qendror i Zgjedhjeve (KQZ), është caktuar si Qendër për numërimin e votave, veprim ky që është në kundërshtim edhe me nenin 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 i cili përcakton se: “Gjatë periudhës së fushatës, subjektit politik, mbështetësve apo kandidatëve të tij i ndalohet të bëjnë një nga veprimet e mëposhtme: vendosja e njoftimeve, pankartave dhe posterave, ose shfaqja e emrave ose sloganeve të tyre në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave ose subjekteve publike, në ose mbi rrugë publike, në shenjat e trafikut publik, brenda ose jashtë ambienteve ose ndërtesave të nxëna ose ndryshe të cilat i përdorin

organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në ambiente private me lejen e pronarit ose përdoruesit.

Pretendimet në përgjigje në ankesë të subjekti politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak - Nenad Rashiq, ku theksojnë se zyra u është dhënë nga Komuna e Leposaviqit për shfrytëzimin e hapësirave për zgjedhjen për kandidat për deputete në Kuvendin e Kosovës dhe se nuk kanë qenë të njoftuar se ishte një qendër votimi për numërim, Paneli konsideron se pretendimi i tillë nuk qëndron sepse subjekti në fjalë nuk ia ka bashkangjitur pëlqimin e lëshuar nga Komuna e Leposaviqit për vendosjen e posterit/banerit në objektin e lartcekur në ankesë, si dhe nuk është kontestues fakti se në vendin ku është vendosur billboard/posteri nga ana e subjektit politik respektivisht e kandidatit Nenad Rashiq objekti në fjalë është prone publike andaj veprimi i tillë bie ndesh me dispozitat ligjore të LZP-se.

Gjithashtu Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën përsëritje të shkeljes së legjislacionit zgjedhor, pra ka bërë shkelje të tilla edhe në proceset e mëparshme zgjedhore. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e posterëve të subjektit të tyre politik për fushatë zgjedhore në hapësira publike gjegjësisht në objektin e lartcekur, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sanksionuar me dispozitën e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nën 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuara më lart, e në kuptim të nenit 33 paragrafi 1 neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 293/2025 më datën 04.02.2025

Kryesuese i Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së